



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 379/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Fortesa" sh.p.k., me seli në Prizren, ushtruar kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me zhavor" me numër të prokurimit 651-23-2383-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal-Gjilan, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 18.08.2023, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Fortesa" sh.p.k., me seli në Prizren, e parashtruar në OSHP me 09.06.2023, Protokolli 379/2023, kurse Vendimi i AK i datës 25.05.2023, për dhënie të Kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me zhavor" me numër të prokurimit 651-23-2383-2-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal-Gjilan, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 28.03.2023, Kuvendi Komunal-Gjilan, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe dosjen e tenderit (DT). Me datë 18.04.2023, ka bërë hapjen e ofertave.

Me 25.05.2023, AK me të dhëna si më sipër, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letrat standarde, me të cilin njoftim e ka eliminuar si të pa suksesshëm ofertën OE ankues me arsyetimin se oferta OE ankues nuk ka qenë me çmimi më të ultë në mesin e tenderëve që i plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Me 30.05.2023, OE “Fortesa” sh.p.k., nga cilësia e tij/sajë si palë e pakënaqur me vendimin e cituar ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 01.06.2023. Kurse, me 09.06.2023, “Fortesa” sh.p.k., ka ushtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është evidentuar me numër të protokollit 379/23.

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 22.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa OE ankues “Fortesa” sh.p.k., të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (vendimit për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe konsideron se janë jo kontestuese faktet se AK ka zbatuar në këtë aktivitet të prokurimit procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës shërbim, vlera e parashikuar 480,000.00 €.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me RROUPP. Në këtë rast, duke i analizuar në tërësi shkresat e kësaj lënde vërehet se ankuesi ka parashtruar vërejtjet eventuale në fazat përkatëse të aktivitetit të prokurimit sepse secili OE disponon me këtë të drejtë.

Pohimet e OE ankues "Fortesa" sh.p.k.

Ankuesi ka pohuar se AK ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP dhe nenit 41 të rregullores për Prokurim Publik (RRPP) ngase OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm për shkak se ka paraqitur ofertë e cila është jo-normalisht e ulët dhe ka ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, rrjedhimisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimit të kontratës. Si dhe AK gjatë vlerësimit të ofertave, ofertën e këtij grupi të Operatorëve Ekonomik AGRO INVEST 1 SHPK & LORD GROUP SHPK & ERMAL SYLAJ B.I, e ka vlerësuar si të përgjegjshme dhe të pasuksesshme. Gjatë qasjes zyrtare në ofertën e këtij Grupi të Operatorëve Ekonomik kemi vërejtur se ky ofertues ka gabuar gjatë krijimit të Formularit për dorëzimin e tenderit pasi tek paralogaria e dorëzuar gjatë ofertimit vlera totale e poenave është 55.175 ndërsa tek formulari është 55175.00. Prandaj oferta e këtij OE do duhej të refuzohej dhe ky OE të cilësohej si i papërgjegjshëm sipas Nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 001/2023. Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet – refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm – KUSHT Administrativ

Përgjigja në pretendimet ankimore nga ana e ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, bazuar në procesverbalin e hapjes dhe raportin e komisionit të vlerësimit, analiza tregon se disa OE ka dorëzuar tender jo normalisht të ulët sipas nenit 41.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, pasi që janë përmbushur tri kushtet e më poshtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Pasi që kanë marrë pjesë 8 operator ekonomik. Vlera e përgjithshme e tenderëve është: $835.75 / 8 = 104.47 / 1.3 = 80.36$ Pra edhe kushti i dytë është plotësuar që të llogaritet si tenderi jo normalisht i ulët. Kushti i tretë kërkon që të jetë më shumë se 10% më i ulët se O.E. i dytë i përgjegjshëm. $98.55 / 1.1 = 89.59$; $69.88 / 1.1 = 63.53$; prandaj disa OE i kanë përmbushur të 3 (tri) kushtet e lartpërmendura, mirëpo AK kontraktues me pastaj nuk ka vepruar ashtu siç parashihet në **paragrafin 1 të nenit 61 të LPP-se**, në të cilin thuhet: “Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafit 2. të këtij neni”, sepse AK – Komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarim vetëm për 2 (dy) OE me çmimin me të lire por jo edhe për OE tjerë të cilët plotësojnë të 3 (tri) kushtet, andaj me këtë veprim AK ka shkelur **nenin 7 par. 2 të LPP-se** ku thotë: “Autoriteti kontraktues nuk do të

ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik”, sepse AK – Komisioni i vlerësimit është dashur apo/ose ka qene i obliguar te kërkoj sqarime për çmimet jo normalisht te ulëta për te gjithë OE te cilët i plotësojnë te 3 (tri) kushtet ne pajtim me nenin 61 te LPP-se, paragrafit 3 te këtyre rregullave, një tender i tillë nuk mund te refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve te rëndësishme qe shkaktoj tenderin veçanërisht te ulët.

Gjithashtu, **Eksperti shqyrtues, sqaron se duke marr për baze nenin 41 .6; 41.8 si dhe 41.9 te Rregullores nr. 001/2023 për Prokurim Publik**, Autoriteti kontraktues me date 12.05.2023 i kërkon sqarime përmes letrës standarde e kërkesë për sqarimin e tenderit lidhur me Punët e lëshesave poz. 1 dhe 2 ne paramasë dhe parallogari si me poshtë:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Në lidhje me aktivitetin e Prokurimit ” Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me Zhavor ”. Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim: Duke u bazuar ne Rregullat për tenderët Jo-Normalisht te ulet nenin 3, ku ju i keni plotësuar te gjitha kushtet për tu trajtuar oferta e juaj si tender jo normalisht te ulet pasi:

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, për pozicionet si në vijim.?

| Punet e lëshesave | | | | | | | | | (Kategoria C 20% e pakëve në vlerësim) |
|-------------------|---|------|---|------|-------|------|------|------|--|
| 1 | Furnimi , transporti dhe punimi i lëshesave, pjesëve kabluzë dhe kabluzëve të mblytura ne dera pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna nga mbikqyrja. Në qmim është llogaritur edhe hapja e kanalit, (ne qmim te llogaritet mbulimi me rërë dhe zhavor) | | | | | | | | |
| | Gyp prej betoni të armuar Ø 1200 mm | m' | 1 | 4.24 | 18.00 | 5.00 | 4.24 | 0.76 | 5 |
| | Gyp prej betoni të armuar Ø 1000 mm | m' | 1 | 2.54 | 18.00 | 3.00 | 2.54 | 0.46 | 3 |
| | Gyp prej betoni të armuar Ø 800 mm | m' | 1 | 1.69 | 18.00 | 2.00 | 1.69 | 0.31 | 2 |
| | Gyp prej betoni të armuar Ø 600 mm | m' | 1 | 1.69 | 18.00 | 2.00 | 1.69 | 0.31 | 2 |
| | Gyp prej betoni të armuar Ø 500 mm | m' | 1 | 1.69 | 18.00 | 2.00 | 1.69 | 0.31 | 2 |
| | Gyp prej betoni të armuar Ø 400 mm | m' | 1 | 1.69 | 18.00 | 2.00 | 1.69 | 0.31 | 2 |
| 2 | Punimi i kokave lyrese dhe dalëse nga betoni i armuar, mvarësisht prej diametrit te gypit. | | | | | | | | |
| | Ø 1200 mm | copë | 1 | 1.69 | 18.00 | 2.00 | 1.69 | 0.31 | 2 |
| | Ø 1000 mm | copë | 1 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 0.85 | 0.15 | 1 |
| | Ø 800 mm | copë | 1 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 0.85 | 0.15 | 1 |
| | Ø 600 mm | copë | 1 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 0.85 | 0.15 | 1 |
| | Ø 500 mm | copë | 1 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 0.85 | 0.15 | 1 |
| | Ø 400 mm | copë | 1 | 0.85 | 18.00 | 1.00 | 0.85 | 0.15 | 1 |

Ndërsa, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka kthyer përgjigje me datën 15.05.2023 duke sqaruar dhe duke prezantuar 2 (dy) marrëveshje , Marrëveshje për punimin, furnizimin dhe montimin me koka hyrëse dhe dalës nga Betoni, lidhur ne mes “El-bau” Shpk – Gjilan dhe “Eken Beton” Shpk – Prishtinë, si dhe marrëveshje për punimin, furnizim dhe montim për gypa të betonit, ne mes “El-Bau” Shpk - gjilan dhe NPT “BESHI COM” Ferizaj (mirëpo këto marrëveshje nuk kanë datë se kur janë lidhur përveç datës se kur janë noterizuar nga Noteri), po ashtu OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka vendosur ne paramas dhe paralogari çmimet të cilat i ka ne këto marrëveshje të cilat nuk specifikojnë kushtet tjera të marrëveshjeve, si dhe ne letrën sqaruese nuk ka ofruar mundësin e rritje se sigurimit të ekzekutimit për AK, ndërsa me date 19.05.2023, autoriteti kontraktues përmes platformës elektronike i drejtohet OE “El-Bau” Shpk për rritjen e sigurimit të ekzekutimit në vlerën 20%, kurse OE “El-Bau” Shpk i kthen përgjigje me date 19.05.2023 se pajtohet të rritet sigurimi i ekzekutimit në masën 20%,. Ashtu siç kam potencua edhe më lartë Autoriteti kontraktues me këto veprime nuk ka respektuar **nenin 7 par. 2 të LPP-së**, ku thotë: *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*. Prandaj autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar në përpikëri kërkesën për informata shtesë për çmime jo normalisht të ulëta. Arsyetimi OE të rekomanduar për dhënie të kontratës pas kërkesë për sqarim të tenderëve dërguar nga autoriteti kontraktues është i përgjithshëm dhe nuk ofron dëshmi relevante sa i përket arsyetimit të ofertës nga ky OE, argumente Marrëveshjet me 2 (dy) operatorët ekonomik, nuk arsyetojnë çmimet e pozicioneve të ofruara, duke marr për baze këto të fundit duhet të jene në një linjë me çmimet e tregut (Komisioni i vlerësimit në raportin e tij potencon se pjesërisht pajtohet, që do të thotë, nuk është bindur dhe askund nuk sqaron se ka analizuar çmimet se a janë të tregut). Rritja e sigurisë së ekzekutimit të tenderit nga 10% në 20% caktuar për OE e rekomanduar për kontrate nga AK, propozuar nga vet Autoriteti kontraktues, është argument i pamjaftueshëm pasi që një manovrim i tillë nuk krijon një trajtëshmëri në ofertimin e çmimeve për këto pozicione, duke krijuar hapësirë kështu për shkeljen e çmimeve të tregut. Bazimi i një vendimi të tillë për çmimet jo normalisht të ulëta, konkretisht **nenit 29.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik**, konsideroj se në rastin konkretë është në kundërshtim me **nenin 61 të LPP-së**, sepse nuk janë besueshme as për AK – komisionin e vlerësimit si dhe nëse krahasohen me objektin, çmimet e tregut dhe në përputhje me rrethanat ka gjase për një performancë jo të mirë të kontratës, sepse me këto çmime nuk mund të arsyetohet vetëm prodhimi se bashku me lëndën e parë, pa llogaritur kostot tjera, andaj AK ka bërë shkelje edhe të këtyre dispozitave pasi që nuk i ka përfill rregullat e prokurimit për tenderët jo normalisht të ulët, po ashtu AK - Komisioni i vlerësimit nuk kanë respektuar **nenin 59 par. 4 të LPP-së**, ku thotë: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*. prandaj duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh analizën e çmimeve sipas **nenit 61 të LPP-së** të dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta **janë të qëndrueshëm**.

Ndërsa, sa i përket pohimit të dytë, Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne procesverbalin e hapjes, paramasen dhe parallogarin si dhe formularin e tenderit lidhur me grupin e operatoreve ekonomik: “Agro Invest 1” Shpk & “Lord Group” Shpk & “Ermal Sylaj” B.I., me rastin e tenderimit ne formularin e tenderit ka vendosur çmimin: 55,175.00 EUR, kurse ne paramasë dhe parallogari ka vendosur çmimin: 55.175 euro, prandaj bazuar ne Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, nenin 40.10 pika b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet, ky grup i GOE është i papërgjegjshëm – oferta refuzohet. Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar 7, 59, 61 dhe 60 të LPP-së, andaj, Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Konstatimet e panelit shqyrtues

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova

materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues se ka pozicione të cilat kanë çmime jo-normalisht të ulëta dhe të cilat nuk korrespondojnë me çmime të tregut, andaj paneli pasi që vëren se OE ankues në ankesën e tij ka ofruar në formë tabelare çmimet referente të marruara nga disa kompani, atëherë vendos që AK gjatë fazës së ri-vlerësimit të bëjë vetë një hulumtim të tregut duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara dhe konform nenit 59 të LPP të bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e të gjitha ofertave të përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 61 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK-Komuna e Gjilanit
- OE ankues
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe zyrtare;